

20220670773

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/ 14, 160 / 14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/19, 275/19, 31/20 dhe 267/20), në nenin 37 paragrafi (1) ndryshon si më poshtë:

“(1) Harmonizimi i pensionit të pleqërisë do të bëhet sipas lëvizjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës në vlerë prej 50% dhe rritjes së rogës mesatare të paguar të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 50%.”

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2) si më poshtë:

“(2) Pensioni i paragrafit (1) të këtij neni harmonizohet më 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti sipas përqindjes së fituar si shumë e rritjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës në gjashtëmujorin e kaluar dhe përqindjes së rritur të rogës mesatare të paguar të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjashtëmujorin e mëparshëm në raport me gjashtëmujorin që i paraprinë.”

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Paragrafët (4) dhe (5) fshihen.

Neni 2

Në nenin 76 pika 1) nënpika 1) lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikëpresje.

Në nënpikën ç) pikëpresja në fund të fjalisë fshihet dhe shtohet lidhëza “dhe”.

Pas nënpikës ç) shtohet një nënpikë e re d) si më poshtë:

“d) piroteknik të punësuar në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit të cilët janë sistemuar në punë dhe detyra si Drejtues Njësie të Piroteknikëve – drejtues ekipi dhe piroteknik”.

Neni 3

Me pagesën e pensionit për muajt mars, prill dhe maj 2022, Fondi do t'i paguajë secilit shfrytëzues një shtesë të njëhershme prej 1.000,00 denarësh të pensionit për muajt mars, prill dhe maj 2022.

Shtesa e njëhershme sipas paragrafit (1) të këtij neni do të paguhet nga mjetet e Fondit.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.